



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR TË DREJTEN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 225/Prot  
3

Tiranë, më 31/3/2016

REKOMANDIM

Nr. 05 datë 31/3 2016

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar në ngarkim të kontrolluesit **Federata Shqiptare e Futbollit (FSHF)**.

KONSTATOVA:

Pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, është paraqitur ankesa e shtetasit me initiale (R. S). Ky shtetas i është drejtuar zyrës së Komisionerit me ankesë ku pretendon se, të dhënat personale që kërkohen për anëtarësim të "Klubi Tifozëve të Kombëtares", me qëllim paisjen me kartën e posaçme, janë të tepërta dhe të pa motivuara në kërkesat për gjendjen civile, edukimin dhe profesionin. Gjithashtu, ankuesi kërkon të dijë në lidhje sigurinë e përpunimit të të dhënave personale gjatë përhapjes ose transferimit të të dhënave.

Në kuadër të bashkëpunimit dhe zgjidhjes së ankesës, zyra e Komisionerit i është drejtuar kontrolluesit, Federatës Shqiptare të Futbollit (FSHF) me shkresën Nr. 225 Prot, datë 03.03.2016, nëpërmjet së cilës u kërkua informacion lidhur me kartën e posaçme për anëtarësim të "Klubi Tifozëve të Kombëtares"

Në përgjigjen e kthyer me shkresën Nr. 335/1 Prot, datë 15.03.2016, FSHF ka paraqitur sqarime, ku është shprehur se:

*-Me qëllim mbështetjen e Kombëtares Shqiptare të Futbollit në UEFA Euro 2016, FSHF ka krijuar "Klubin e Tifozëve të Kombëtares". Ky klub synon krijimin e një komuniteti të njohur dhe të formalizuar me një organizim të posaçëm që sjell një sërë avantazhesh dhe privilegjesh për anëtarët e tij.*

*-Krijimi i një baze të dhënash për nr. e tifozëve, nivelin e tyre arsimor etj. Kjo për t'u siguruar anëtarëve, dhuratat apo materiale promocionale, si dhe privilegje të tjera në varësi të llojit të anëtarësimin.*

*-Janë marrë të gjitha masat organizative dhe teknike në lidhje me sigurinë e përpunimit të të dhënave.*

Zyra e Komisionerit vlerëson bashkëpunimin e kontrolluesit në kuadër të dhënies së informacionit në lidhje me rastin konkret. Pas shqyrtimit të informacionit dhe verifikimit të kryer në faqen e internetit të FSHF-së, rezulton se kërkesat për t'u anëtarësuar në "Klubi Tifozëve të Kombëtares" ndahen sipas rubrikave Detajet e Llogarisë, Detajet Personale, Adresa, Adresa alternative, Nivele të Anëtarësimit, Privatësia dhe kontrolli i sigurisë në të cilën janë të përfshira dhe Termat/Kushtet e Marrëveshjes.

Në rubrikën "Detajet Personale", kërkohen të dhëna për gjendjen civile (beqar, i martuar, divorcuar, i ve). Në lidhje me kërkesën për përpunimin e këtyre të dhënave, në respektim të nenit 5/1/c të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, për të arritur qëllimin e deklaruar nga kontrolluesi, kërkohen më shumë të dhëna personale se sa është e nevojshme.

Në këtë kuadër, kontrolluesi duhet të respektojë me rigorozitet dispozitën e mësipërme (neni 5/1/c). Kërkesa për të dhëna personale beqar, i martuar, divorcuar ose i ve, vjen në kundërshtim me detyrimet e përcaktuara në ligj, mbrojtja e të dhënave personale bazohet në mjaftueshmërinë e të dhënave, të cilat duhet të lidhen me qëllimin e përpunimit dhe të mos e tejkalojnë këtë qëllim.

Në rubrikën "Privatësia dhe kontrolli i sigurisë", ku janë të përfshira dhe Termat/Kushtet e Marrëveshjes, e cila është e vetmja pjesë e faqes së internetit të Federatës Shqiptare të Futbollit që flet për mbrojtjen e të dhënave personale, shpjegimet e dhëna janë të paqarta për të arritur qëllimin e krijimit të saj.

Çdo kontrollues që përpunon të dhëna personale, ka detyrimin të publikojë në faqen web-sitit të internetit "Politikat e privatësisë". Informimi i subjekteve të të dhënave ose çdo personi që viziton faqen me mënyrat e mbledhjes, përpunimit, ruajtjes, masat e marra për sigurinë e të dhënave personale si dhe të drejtat e subjekteve të të dhënave dhe detyrimet e kontrolluesit në kuadër të mbrojtjes së privatësisë, legjitimon përpunimin e të dhënave personale dhe u jep mundësi reale për të shfrytëzuar të drejtat ligjore.

Mospublikimi i "Politikave të privatësisë" në faqen e internetit, privon subjektet e të dhënave personale nga e drejta për informim (në bazë të nenit 18) dhe të drejtat e parashikuara në kreun IV "Të drejtat e subjektit të të dhënave", të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, duke mos u dhënë mundësi në ushtrimin e tyre dhe duke i cënuar rëndë ato.

Në frymën e ligjit, çdo kontrollues që përpunon të dhëna personale, pavarësisht faktit nëse përpunimi bëhet në mënyrë elektronike apo manuale, dhe pavarësisht faktit nëse mbledh apo jo të dhëna personale nëpërmjet faqes/web-sitit në internet, ka detyrimin që të publikojë "Politikat e privatësisë", pasi kontakti paraprak i çdo subjekti të dhënash realizohet nëpërmjet faqes/web-sitit në internet. Në këtë kuadër, publikimi i "Politikave të privatësisë" përmbush më së miri qëllimin që ka neni 18 i ligjit.

Gjithashtu, nga verifikimi i kryer në regjistrin elektronik të subjekteve kontrolluese të hapur për publikun dhe në protokollin e Zyrës së Komisionerit, rezulton se FSHF nuk ka përmbushur detyrimin ligjor për njoftim. Në paragrafin 1, të nenit 21, të ligjit të sipërcituar,

parashikohet: “Çdo kontrollues duhet të njoftojë Komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës. Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit, sipas nenit 22 të këtij ligji”.

Në nenin 25/1 të ligjit, parashikohet që kontrolluesi nuk mund të fillojë përpunimin e të dhënave personale pa njoftuar më parë zyrën e Komisionerit. Me miratimin e ligjit, kontrolluesi nuk duhet të vazhdojë përpunimin e të dhënave personale pa njoftuar dhe pa u regjistruar më parë, në Regjistrin Qëndror të subjekteve kontrolluese, të administruar nga Zyra e Komisionerit.

Sa më sipër,

Në zbatim të neneve 5, 6, 18, 21, 29, 30 dhe 32 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, si dhe nenet 107-109 të Kodit Proçedurave Administrative;

### REKOMANDOJ:

1. Në zbatim të nenit 5/1/c të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, të merren masat e duhura teknike dhe organizative për të bërë të mundur heqjen nga kërkesat për anëtarësim të “Klubi Tifozëve të Kombëtares”, në rubrikën “Detajet Personale”, të kërkesës për të dhënat personale mbi gjendjen civile (beqar, i martuar, divorcuar ose i ve), për sa kohë që ky përpunim tejkalon qëllimin e përpunimit.
2. Në faqen e internetit të kontrolluesit, të publikohen në një rubrikë të veçantë “Politikat e privatësisë” dhe të përditësohen të dhënat, me qëllim informimin e personave që vizitojnë faqen, mbi mënyrat e përpunimit të të dhënave personale, masat e sigurisë dhe ruajtjes së konfidencialitetit, të drejtat e subjekteve të të dhënave dhe detyrimet e kontrolluesit në kuadër të mbrojtjes së privatësisë.
3. Në zbatim të pikës 1, të nenit 21, të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, të njoftojë për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës nëpërmjet plotësimit të formularit të njoftimit, manualisht ose online në faqen zyrtare të Zyrës së Komisionerit. Ky detyrim të plotësohet brenda 5(pesë) ditëve nga data e njoftimit të këtij rekomandimi.
4. Në zbatim të nenit 32/1 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, me plotësimin e detyrimit sipas pikës 1 dhe 2, të njoftohet me shkrim pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
5. Në rast mospërbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht, në rastet e përsëritura të moszbatimit të

rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky rekomandim u shpall sot më datë 3/3/2016.

**Besnik DERVISHI**  
  
**KOMISIONERI**  
